

Skavicat, buti i Danaideve, dhe “ekonomia e gjelbër” bujqësore

Në mitologjinë e Greqisë së lashtë, Danaidet ishin 50 motra. Gra ekstremisht të bukura. Të bukura njësoj si Shqipëria jonë.... Por ato ishin pa fat..... Këtu nuk po e vazhdoj më analogjinë me Shqipërinë... Bëjeni ju vetë. Danaidet nga vetëbesimi i tepruar bënë një krim të shëmtuar..... Njësoj fjala vjen, sic bëmë ne me pyjet tona, apo me ujërat tona, apo me tokën tonë, apo edhe me bregdetin tonë. Prandaj Zeusi i dënoi ato: i detyroi të ngarkonin ujë për të mbushur një but, një enë të madhe. Sapo ta mbushnin atë, dënimi do të quhej i kryer. Veçse Zeusi ishte i ashpër. Danaidet nuk u cliruan kurrë nga dënimi. Sepse buti që u ishte caktuar të mbushnin ishte i çpuar dhe i shpartalluar plot vrime. Danaidet hidhnin ujë, por buti kurrë nuk u mbush, deri sa ato vdiqën...

Prej atëherë, për këdo që bën punë kot dhe con mallin dëm pa mend në kokë e pa laps në dorë, njerëzit krijuan shprehjen “mos mbush butin e Danaideve”. Në qytetërimin e sotëm buti i Danaideve është simboli i një lloj ekonomie të vjetëruar tashmë. Kjo lloj ekonomie konsumon shumë lëndë të parë për të prodhuar pak, konsumon shumë energji për të prodhuar pak, krijon shumë mbetje, për të prodhuar vetëm fare pak. Shkurt, kjo është një ekonomi aspak e zgjuar. Është pra ekonomia e çpuar si buti i Danaideve që nuk mbushet kurrë... Kjo është pak a shumë ekonomia që kemi që prej Revolucionit Industrial, pra që prej 250 vjetësh: shumë lëndë e parë, shumë energji, shumë mbetje, pak fitim, kosto e madhe sociale dhe mjedisore, shumë probleme. E pra, ky është tashmë një luks të cilin njerëzimi nuk ia lejon dot më vetes. Dhe prandaj, ai ka vendosur ta ndryshojë urgjentisht dhe rrënjësisht.

Kur ka vendosur ta ndryshojë? Që në 2012, në Konferencën e Rio de Janieros, por realisht ka filluar të veprojë këto 4-5 vitet e fundit. Vecanërisht me programin e qeverisë së re të Evropës, pra me programin ambicioz “Green Deal – Marrëveshja e Gjelbër” të Komisionit të ri Evropian në 2020.

Si do ta ndryshojë nw pwr gjithwsi njerëzimi këtë ekonomi? Njësoj sic do të duhej të vepronin Danaidet: duke ia mbyllur vrimat butit, me qëllim që puna e tyre për ta mbushur atë të kishte rezultat. ...Ashtu edhe ekonomisë së vjetër njerëzimi ka vendosur t’ia mbyllë vrimat që e bëjnë të ngjajë me butin e Danaideve. Ekonomia duhet të konsumojë më pak lëndë të para, dhe mundësisht t’i përdorë ato dhe t’i kalojë nga një industri tek tjetra. Ekonomia duhet të konsumojë më pak energji, dhe natyrisht të krijojë sa më pak mbetje në fund të procesit.

Këto janë parimet e këtij lloji të ri të ekonomisë, të ekonomisë së gjelbër. Ekonomia e gjelbër nuk është luks. Është para', është fitim. Ja psh. Ekonomia e gjelbër na zbulon se Shqipëria ka një 800 MW kapacitet energjie të fshehura, të cilat i hedh në ajër kot, i con dëm, njësoj si ujin në butin e Danaideve. Nga vijnë këto 800 MW? Nuk vijnë nga Skavica. Nuk vijnë as nga Fierza. Ato madje janë sa Fierza dhe Skavica të marra së bashku, vecse janë të shpërndara në gjithë territorin e Shqipërisë. Fiks afërsisht 800 MW është sasia e energjisë, që ne shqiptarët konsumojmë për shkak se i kemi edhe banesat si buti i Danaideve: banesave tona ne “u hedhim” energji për t'i ngrohur e ato nuk ngrohen, e u hedhim energji për t'i ftohur e ato as nuk ftohen. Vetëm nga një program termoizolimi do të fitonim 2 Skavica bashkë, pra mbi 800 MW energji. Skavica kushton 1 miliardë dollarë. Aq do të kushtonte edhe programi i termoizolimit të ndërtesave. Vecse ndërtesat e termoizoluara do të përmirësonin rrënjësisht cilësinë e jetesës e do të ulnin sëmundshmërinë nga të ftohtët, etj.

Ja pra. Vetëm me termoizolim, do të kursenim energji aq sa mund të prodhohej nga një hidrocentral prej 800MW. Kjo do të thotë se rreth 35% të energjisë që prodhojmë në Shqipëri, ne e hedhim poshtë, e cojmë dëm. Cojmë dëm gjithë këtë energji, ndërkohë që kërkojmë të harxhojmë para' për të ndërtuar Skavicën mbi Drin, Kalivacin e Pocemin mbi Vjosë, dhe dhjetëra hidrocentrale të vogla në cdo përrua në Shqipëri. Kjo është pra “ekonomia e gjelbër”: të tregohesh i mencur dhe të mbyllësh hapësirat prej nga ku të ikën puna dhe malli dëm. Nëse do investonim po aq para' sa Skavica në termoizolim, do të rrisnim maksimalisht eficensën e energjisë, që është një nga shtyllat e ekonomisë së gjelbër. Nuk do të kishim nevojë të përmbytim tokë buke për liqenin e Skavicës. Eficensa e energjisë mund ta bëjë Shqipërinë pra, superfuqi në energji.

Tani imagjinoni c'ndodh kur eficensa e energjisë bashkohet edhe me bujqësinë. Bujqësia në Shqipëri është një nga fushat me më shumë mundësi dhe potencial për ekonominë e gjelbër. Edhe në SHBA, studimet e fundit dëshmojnë se për fermat e vogla e të mesme, sic janë këto tonat, eficensa e energjisë mund të jetë një nga 4 burimet më të rëndësishme të kursimit dhe të fitimit. Psh në Shqipëri, termoizolimi i gjithë ndërtesave të vogla të një ferme do të kishte një kosto vetëm prej 2.000 lekë për metër katror mur, ndërsa ky investim do të mund të rikthehej brenda 5-7 vjetëve, dhe më tej vetëm do të sillte fitim nëpërmjet kursimit. Ndërkohë që cilësia e të jetuarit në ato banesa përmirësohet 100%, dhe sëmundshmëria (ftohje, etj) për banorët e fermës ullet me 80%, cka do të thotë se indirekt rritet efektshmëria e fuqisë punëtore në punët e fermës.

Bujqësia dhe fermat bujqësore në Shqipëri kanë mbi 20 vjet që kanë filluar të përdorin energjinë diellore për ngrohjen e ujit të banesave dhe fermës në përgjithësi. Por janë ende shumë pak. Mbi 70% të nevojës për ujë të ngrohtë në Shqipëri ne e plotësojmë me boilerat elektrikë, pra që konsumojnë energji elektrike. Ndërkohë, Shqipëria ka një potencial prej 260 ditë me diell në vit. Imagjini! Kjo do të mjaftonte disa herë për të plotësuar nevojat me ujë të ngrohtë. Në nivel vendi, kjo mund të shpëtonte të paktën edhe rreth 300MW të tjera kapacitet energjie të instaluar, pra afërsisht sa një Skavicë tjetër e re.

Pra, kapaciteti i termoizolimit dhe i përdorimit të energjisë diellore, kudo por vecanërisht në zonat rurale dhe në fermat bujqësore, është shumë i madh. Janë gati 3 Skavica, të cilat mund të “ndërtohen” në bashkëpunim me fermerët dhe gjithë qytetarët e Shqipërisë. Duhet dy programe në nivel kombëtar. Vetëm me këto dy programe kombëtare ne do të krijojmë në Shqipëri një sektor të tërë të “ekonomisë së gjelbër” të përbërë nga sipërmarrje të gjelbra të shpërndara nëpër territor, të cilat krijojnë mijëra vende pune të reja me statusin “vende pune të gjelbra”. Ky lloj punësimi mbështetet edhe financiarisht nga BE dhe nga OKB. Përfitimi i këtyre dy programeve është i madh, sepse fitojnë të gjithë: fitojnë fermerët, krijohen vende të reja pune të gjelbra, gjenerohet GDP, çlirohet kapacitet prodhues i energjisë për vendin, përfiton mjedisi, përfiton Shqipëria. Për Shqipërinë kjo vjen edhe si pjesë e “tranzicionit të gjelbër”, si një nga objektivat e promovuar nga Procesi i Berlinit dhe pjesë e paketës 30 miliardë Euroshe që u promovua nga Komisioneri Varhelei në Samitin e 10 qershorit mes vendeve të rajonit në Tiranë.

Ajo që duhet më së pari pra është një plan kombëtar ndërgjegjësimi me qëllimin që të kuptojnë dhe të binden fermerët se këto ndërhyrje nuk janë thjesht mjedisore, por janë ekonomike. Me këto ndërhyrje bashkohet ekonomia me dimensionin e gjelbër, duke krijuar ekonomi të gjelbër në gjithë zonat rurale dhe në bujqësi, por jo vetëm. Ministria e Punës dhe ajo e Ekonomisë duhet të guxojnë. Potencialet janë të mëdha, dhe probabiliteti për sukses është 100%. ...Ka ardhur momenti që Danaidet edhe në Shqipëri më në fund të amnistohen. Buti ynë nuk mund të mbetet përjetë i çpuar...

Prof. Dr. Romeo Hanxhari

